




National Endowment
for Democracy
Supporting freedom around the world



INSTITUTE OF SOCIAL SCIENCES
AND HUMANITIES
SHQIPËRI




Hapat tehemlore
të **polarizimit** dhe
populizmit



Autorë: Ekipi i ISSHS-Shkup

Hapat tehemlore të
POLARIZIMIT DHE POPULIZMIT

Shkup, 2019




Instituti për shkencë shoqërore dhe humanistike në vitin e kaluar krijoi dy analiza në temë “polarizim i diskursit publik si mjet i qeverisjes populiste”. Analizat e Institutit shtrihen në dituri paraprake të publikimeve të shumta shkencore me kompetenca analitike, si dhe publicistikë referente. U konsultuan revista dhe monografi shkencore, prej Journal of Democracy e deri në Contre le liberalism nga Alan de Benoà (2019), si dhe të dhëna në terren për partitë populiste dhe lëvizjet në suaza të Zgjedhjeve Europjane të vitit 2019, por dhe burime disa vjet më të vjetra dhe të cilat vijnë nga Europa Lindore dhe pjesë të tjera të botës. Duke u mbështetur në premisat dhe recetat e Ernesto Laclau (Ernesto Laclau) në veprën e tijë klasike, On Populist Reason (2005), si dhe burimet të tjera të përmendura, mundet të përfundojmë se populizmi çdroherë është qeverisje iliberale dhe themelohet në taktikat vijuese diskurzive.

1. Ndarja e “popullit” dhe “elitave”.

99% vs. 1%
POPULLI I PASTËR ELITA LIBERALE

2. “Populli” çdoher është i drejtuar nga lideri i cili është riinkar-nim i vullnetit dhe zërit të popullit.



3. Përhapet logjika se sistemi është deri në atë shkallë i kor-ruptuar nga elitat sa që vetëm lideri i cili u kundërshtohet dhe reshtohet në anën e popullit mundet të sjellë drejtësi dhe rregull.



4. Lideri e flet gjuhën e popullit, joprofesionale, gjuhë spontane të së drejtës spontane dhe me të cilën krijohet efekti i nder-shmëri dhe origjinalitet.



5. Fjalimi i mësuar dhe ekspertik shëndrohet shenjë e elitës dhe nënkoptohet se është hipokrit dhe shpesh i rremë.

1%  = FAKE

6. Iluzionet e paraqitura nga populist, madje edhe gënjeshtat apo pasaktësitë, përjetohen si më të vërteta se sa e vërteta faktike për shkak se burojnë nga vendi “autentik”, “pozita autentike”, e singertë në qëllimin e tyre përfundimtare (bile edhe kur gëjnen). Prandaj flitet për “post-vërtetë” si strategji.

FAKE  POSTTRUTH

7. Ndërimi populistik “spontan” i autoritetit të institucioneve mundet të ndodhë vetëm kur te shumica e popullit zhvillohet sentiment cinik për mosbesim në institucionet.

99%  

8. Drejtësia spontane e rrugës perceptohet si më autentike dhe prandaj institucionet kanë kuptim dhe legjitimitet vetëm në qoftë se janë mjet në duart e inkarnacionit të popullit – liderit.



9. Është suspenduar autoriteti i institucioneve, të cilat sipas natyrës së tyre u takojnë elitave, vetëm në qoftë se lideri nuk u jep legjitimitet të autenticitetit. Ky legjitimitet vjen nga partizimi i tyre, apo politizimi ideologjik i tyre i përshtatshëm.



10. Qeveris anti-intelektualizëm, kurse ekspertiza ndërrohet për të singertën brutale.



11. Sa më shumë e singerta është brutale së shpejti shëndrohet thjeshtë
– BRUTALE.

“REALITETI DHE MË TEJ” JU PARAQET

TRILERI I RI
NGA PRODUCENTËT E
“TI NUK KE LEGJITIMITET”

~~NUK FLAS~~ ME
KRIMINELË

NË SHITËPITË TUAJA QË NGA VITI 2015



Shumë nga analizat krahasuese, studimet dhe të dhënat tregojnë se këto elemente janë cilësuese në shumë nga rendet populiste (dhe, pashmangshëm, iliberale) dhe se paradigma populiste është në ritje, jo vetëm në Europën Lindore por dhe në Europën Perëndimore dhe përtej Atlantikut. Në qoftë se dëshmojmë ndryshim të paradigëmës, duhet të kemi ndër mend se me largimin nga qeverisja e Nikolla Gruevskit dhe VMRO-DPMNE, populizmi dhe iliberalizmi, patjetër nuk janë tejkaluar me domosdoshmëri dhe me definicion. Në qoftë se detektojmë cilin do qoftë nga elementet e përmendura më lartë në diskursin e qeverisë të tanishme apo të ardhshme, duhet ta kemi në mend se themeli i populizmit dhe iliberalizmit është vendosur.

Populizmi i majtë është “më i butë” në autoritaritetin e tij:

1. Liria e shprehjes nuk është e shkurtuar deri në shkallën e cila është karakteristike për populizmin e djathtë, por konfrontacioni me media të përcaktuara dhe me gazetarë ekziston, si dhe refizimi të legjitimizohen si media (tu jepet deklaratë apo intervistë);
2. Partia ekziston si inkarnacion i vullnetit të popullit dhe me këtë “partokratia” (apo robërimi i shtetit nga partia në qeveri), por politikat e qeverisë janë populare te masat e gjëra nga aspekti social (kundrejt popularitetin e narativave të mëdha kombëtare te populistët e djathtë);
3. Populizmi i majtë në kontekst të rendit kapitalistik, në retorikën e tij të “revolucionaritetit” shpejtë fillon të tingëllojë rremë dhe dëshpëron (për shkak se autenticiteti është kyçës për diskursin populist) për shkak se pjesëmarja me rendin global bëhet e dukshme;
4. Populizmi çon për kah autoritarizëm, dhe kjo nuk është në përputhje me idealet e majta – që përsëri çon në dëshpërim apo gjoja zbulim të hipokrizisë së elitës (të majtë populiste) së re.

TË PA LARË VS TRADHËTARË

SFIDA 1: HARTONI TEKSTIN*

Malet maqedonase këndojnë,
Goce Dellçev, Pitu Guli,
Populli Maqedonas lufton,
për të drejtat e veta!
dielli i ri i lirisë!
Maqedonia e lirë,
Lirshëm jetonë!
Populli Maqedonas lufton,
për të drejtat e veta!
Përsëri tani, flamuri po fluturon,
Kënga të reja, gazeta të reja!
Maqedonia e lirë,
Sot mbi Maqedoninë, po lind,
Në Republikën e Krushevës!
Dame Gruev, Sandanski!
Goce Dellçev, Pitu Gulli,
Dame Gruev, Sandanski!
Lirshëm jetonë!

*Paralajmërim: Derisa ne e zgjedhim këtë gjezë, një njeri në Republikën sëmured nga kanceri për shkak të ajrit të ndotur.

Në qoftë se vërtetë prezencë definuese të pjesës më të madhe të elementeve lartëpërmendura mundemi të konstatojmë se gjindemi në rendin populistik. "Populli kundër elitave" është premisa e parë polarizuese e cila çon deri te tjerat: populli i vërtetë kundër tradhëtarëve, media të vërteta kundër të rremeve, qeveri e vërtetë kundër pretendentëve të rremë për qeverisje. Me fjalë të tjera – parimi se çdoher ka edhe anë tjetër (barabartë legjitime) është asgjësuar. Ka vetëm një të vërtetë, vetëm një anë, ka vetëm monolog dhe jo dialog, ka vetëm "ne" dhe "ne jemi gjithë populli që konsiderohet (si i atillë – popull)". Në qoftë se është dominuese kjo qasje te përkrahësit e një qeverie, pa marrë parasysh a është me prejardhje të majtë apo të djathtë, populizmi dhe iliberalizmi (rrobërimi partiak i institucioneve) janë të pashmangshëm.

